



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 25 maj.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit sot do merren në shqyrtim 14 çështje.

Pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”, çështje e cila vjen nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të raportohet nga zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Relacioni mbi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të

gjitha niveleve, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, respektivisht me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, brenda afatit të kandidimit, kandiduan gjithsej gjashtë kandidatë dhe konkretisht: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}. Konkretisht, kandidimet për këtë pozicion të lirë paraqiten në formë tabelare si më poshtë. Janë paraqitur të gjithë emrat.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë ose të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të emërimit në Gjykatën e Lartë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” si dhe të pasurisë dhe figurës.

Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, kjo me qëllim për bërjen e kësaj të fundit funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të

kandidimit, pikërisht atyre të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kritereve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

Ndërsa procedura e verifikimit të plotësimit të kritereve ligjore të kandidimit ishte në vijim, kandidatja znj. {...} u tërhoq nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mbi këtë kërkesë, me vendimin nr. 105, datë 25.03.2022, Këshilli vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion”.

Lidhur me kandidimin e z. {...}, me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022, Këshilli vendosi skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, ndërsa ndaj kandidatit ishte dhënë masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndaj këtij vendimi, kandidati paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ndërkohë që kjo e fundit me vendimin nr. 37, datë 01.06.2022 vendosi rrëzimin e padisë.

Për katër kandidatët e tjerë, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të të gjitha kritereve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar. Konkretisht:

1) Për z. {...}, i cili ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 174, datë 05.05.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë;

2) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 130, datë 06.04.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë;

3) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 129, datë 06.04.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

4) Për z. {...}, i cili ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 115, datë 29.03.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2021, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019.

Ndërsa proceset e verifikimit të kriterëve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 193, datë 27.05.2022, filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me

vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, jam caktuar unë si relator.

Më datë 27.05.2022, në rrugë elektronike, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes.

Gjatë vijimit të procedurës së përzgjedhjes, njëri nga kandidatët, z. {...}, paraqiti kërkesë për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e përzgjedhjes, kërkesë e cila u miratua më vendimin nr. 258, datë 15.07.2022 të Këshillit. Me anë të këtij vendimi, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 për kandidatin z. {...}.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, relatori administroi dokumentacionin përkatës të secilit kandidat që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për ata.

Kështu, për kandidatin z. {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 456, datë 02.11.2022 dhe nr.3, datë 16.01.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 536, datë 14.12.2022 dhe nr. 537, datë 14.12.2022, vendime të cilat tashmë janë përfundimtarë. Kjo e fundit ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit për vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2021, konkretisht vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022. Lidhur me këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si e tillë, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë. Ndaj vendimit nr. 536, datë 14.12.2022 nuk rezulton të jetë paraqitur ankim brenda afatit ligjor, referuar informacionit të dërguar përmes

komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 4, datë 16.01.2023 dhe nr. 161, datë 06.04.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatit, përmes komunikimit elektronik të datës 18.04.2023, përmes të cilës ka shprehur dakordësinë për të. Ndërsa, lidhur me vendimin nr. 4, datë 16.01.2023, referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023, nuk rezulton të jetë paraqitur ankim.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV, të Vendimit 70/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur nga Këshilli me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajt në konsideratë pika 9, e Ligjit për Statusin, - të cilin nuk po e citoj.

Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 70/2020, dalë në zbatim të pikës 14, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, u përfshinë tre kandidatë, konkretisht: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}. Për këta tre kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë/emërimin ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditjeje.

Bazuar në hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të pikës 9, të Ligjit për Statusin, si dhe Vendimit të Këshillit 70/2020, relatori i procedurës së përzgjedhjes realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, duke identifikuar dhe kandidatin e renditur më lart.

Mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes, mbështetur në dsispozitat përkatëse, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin Paraprak të Propozimit për Emërim nr. 212, datë 28.04.2023, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr.535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) znj. {...};

2) znj. {...} dhe z. {...};

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatës znj. {...}.

Vendimi sipas pikës së mësipërme, të këtij relacioni, iu njoftua rregullisht, (më datë 28.04.2023 përmes komunikimit elektronik) dhe më datë 04.05.2023, në rrugë elektronike, vendimi i arsyetuar iu është dërguar kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, të cilët, bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit. Gjithashtu, ky vendim iu është njoftuar në mënyrë shkresore të tre kandidatëve, të cilët rezultojnë të kenë marrë dijeni në rrugë postare, përmes “lajmërim marrje” më datë 04.05.2023.

Përmes informacionit të disponuar në rrugë elektronike nga Gjykata Administrative e Apelit, më datë 23.05.2023, protokolluar pranë Këshillit me shkresën nr. {...} prot., datë 23.05.2023, rezultojnë se kandidati z. {...}, nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 212, datë 28.04.2023.

Kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, më datë 28.04.2023, konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin. Po ashtu, kjo candidate, në rrugë elektronike, po më datë 28.04.2023, i bëri të ditur Këshillit të Lartë Gjyqësor se nuk kishte ankim ndaj vendimit.

Kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, më datë 04.05.2023, konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin e arsyetuar. Rezultojnë se ndaj vendimit nr. 212, datë 28.04.2023, znj. {...} ka ushtruar ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin

nr. 28, datë 19.05.2023 ka vendosur rrezimin e kërkesës, duke përcaktuar që vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Në kushtet e përmendura më sipër, konsiderohet se, Vendimi Paraprak i propozimit për emërim nr. 212, datë 28.04.2023, mori formë të prerë sipas ligjit, duke u shndërruar kështu në vendim përfundimtar.

Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 70, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin përfundimtar të propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit të renditur më lart, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021.

Projektvendimi titullohet “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates znj. {...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit përmban propozimin për Presidentin e Republikës, të emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidates znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po!

Marçela Shehu: Kisha një pyetje.

Në relacion thuhet që ndaj vendimit paraprak të propozimit është ushtruar e drejta e ankimit dhe Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 28, datë 19.05.2023, mbi

ankimin e znj. {...} për vendimin e propozimit paraprak, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë duke përcaktuar që vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

A kemi një kopje të vendimit nga gjykata?

Dritan Hallunaj: Po, ka një kopje të vendimit.

Marçela Shehu: Të arsyetuar?

Dritan Hallunaj: Po, më duket.

Dy minuta, mund ta marrë.

Marçela Shehu: A mund ta kemi?

Është i shkurtuar apo është i arsyetuar?

(Ndërkohë merret informacioni i kërkuar.)

Dritan Hallunaj: Është vetëm dispozitivi, shkurtim vendimi.

Po jua vë në dispozicion tani.

Marçela Shehu: Atëherë unë vlerësoj që duhet t'i drejtohem Gjykatës së Apelit Administrativ për një kopje të arsyetuar të vendimit, si dhe për të marrë një informacion nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar e drejta e rekursit apo jo. Megjithëse thuhet (në shënimin që ka bërë relatori) që Gjykata e Apelit paska vendosur që ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Kjo është kërkesa imë, pastaj e vlerëson Këshilli. Unë do doja t'i drejtohem Gjykatës për një kopje të vendimit të arsyetuar dhe një informacion nëse është ushtruar e drejta e rekursit apo jo.

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Me sa mbaj mend unë zonja Shehu ka qenë relatore e procedurës së plotësimit në Gjykatë të Lartë për një nga pozicionet e të drejtës administrative, i cili është plotësuar së fundmi nga ana e Këshillit dhe vetë ajo si relatore kur na e ka sjellë propozimin na e ka sjellë me dispozitive, nuk kanë qenë të arsyetuara mbaj mend as vendimet.... Pozicioni duhet të ketë qenë pozicioni i dytë dhe i parë, ka qenë zoti {...} me sa mbaj mend, i cili ka dalë dhe ne nuk e kemi pritur arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, kur zonja {...} kishte ankimuar renditjen. E kemi sjellë dhe e kemi kaluar me dispozitiv. Madje me dispozitiv të vendimit kemi kaluar edhe rrëzimet e padive për të cilat Gjykata e Apelit Administrativ kishte marrë në shqyrtim paditë e kandidatëve ndaj vendimeve të vlerësimit.

Në këto kushte, ka edhe një ndryshim tjetër, që parashikimi në ligj që vendimi i Gjykatës së Apelit, në rastin e renditjes dhe propozimit, është i formës së prerë dhe përfundimtar, është bërë së fundmi me propozim të Këshillit për ta ndryshuar, me qëllim që të mos kishim më vonesa të pritjeve të rekurseve. Fakti që është i formës së prerë dhe përfundimtar, nënkupton faktin që ndaj këtij vendimi nuk lejohet rekurs dhe pikërisht për këtë shkak ne nuk lejuam as rekursin në Gjykatën e Lartë për zotën {...}.

Për këtë arsye, unë mendoj që pavarësisht se zonja Shehu e kërkon (ndoshta për arsyet e saj) për të parë arsyetimin e vendimit, për efekt të procedurës unë mendoj që nuk është e nevojshme një pritje e arsyetimit të vendimit, aq më tepër që tashmë e kemi një praktikë të mbajtur, ku vetë zonja Shehu ka qenë relatore.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Jo pa qëllim e kërkova vendimin e arsyetuar, nuk mbaj mend kur kam qenë relatore dhe për cilin kandidat, gjithsesi e marrë të mirëqenë atë që thotë zonja Ukperaj, nuk e vë në dyshim.

Në rastet e tjera, Gjykata e Apelit Administrativ ka dhënë të drejtën e rekursit palës që ka bërë ankim ndaj vendimit të Këshillit. Ky është rasti i parë, me sa di unë

(mbase gabohem) që Gjykata e Apelit ka thënë që ky vendim është përfundimtar. Unë do doja arsyetimin e vendimit, për të parë çfarë është shkruar. Nëse Këshilli mendon që nuk është e nevojshme, atëherë mund të procedojë...

Rasti i kandidatit (pa i përmendur emrat) që ne kemi vendosur që nuk ushtrohet e drejta e rekursit, është një dispozitë tjetër specifike për rastet e kualifikimit.

Brikena Ukperaj: Është parashikim i ligjit ky, që ndaj vendimit të propozimit të renditjes, ky vendim është i formës së prerë dhe është përfundimtar. Është i njëjti parashikim, edhe për këtë rast edhe për rastet e magjistratëve.

Marçela Shehu: Tre anëtarët e apelit administrativ, kanë qenë të tre një zëri për këtë apo kanë pasur mendime kundër për të drejtën e rekursit?

Brikena Ukperaj: Unë nuk jam anëtare e Gjykatës së Apelit Administrativ që të jap përgjigje, por lexoj ligjin dhe ligji e ka të qartë.

Marçela Shehu: Më fal, ishte pyetja për relatorin. Ndjesë!

Zoti relator, ju lutem, të tre gjyqtarët kanë qenë unanimit në këtë vendim apo jo?

Dritan Hallunaj: Atëherë, disponoj vendimin e shkurtuar ku janë trupa, paditësit, palët, është pjesa “vëren” dhe në fund është pjesa “Për këto arsye vendosi, rrëzimin e padisë [...]. Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë. U shpall sot në Tiranë, datë 19.05.2023”. Është nënshkruar nga të tre anëtarët. Nuk ka një pakicë ku thuhet që “pjesërisht kundër për pjesën e ankimit”. Unë ia vë në dispozicion anëtarëve për t’u njohur me të.

Naureda Llagami: Për procedurë, kalojmë në votim propozimin e Marçelës, e cila kërkon arsyetimin e vendimit.

Në fakt Albani ka një farë të drejte... Ne kemi pasur një praktikë që kemi ecur

vetëm me shkurtim vendimesh dhe kjo është praktikë e konsoliduar. Por kërkesa është kërkesë dhe Këshilli duhet të shprehet mbi kërkesën. Kështu që vijojmë.

(Anëtarët konsultohen me ligjin “Për statusin”.)

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim kërkesën e zonjës Shehu e cila kërkon të administrohet në dosje vendimi i arsyetuar.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i zonjës Shehu.)

Naureda Llagami: Vijojmë tashmë me propozimin e relatorit. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Në kushtet kur kërkesa u rrëzua, me pjesën tjetër të vendimit nuk kam diçka për të kundërshtuar, jam dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidates znj. {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu):¹

2.1 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar;

2.2 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------------|---------------------------------|
| <i>12. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>13. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>14. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>15. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>16. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>17. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës.

- 18. Ridvan Hado* (anëtar)
19. Alban Toro (anëtar)
20. Marçela Shehu (anëtare)
21. Brikena Ukperaj (anëtare)
22. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu):²
 - 2.1 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar;
 - 2.2 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër jo më pak të rëndësishme sesa kjo që kaluam, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Janë dy projekt-akte që kanë të bëjnë me fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar dhe me fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i paraqet për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare dy projektvendime dhe relacionin shoqërues mbi fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar dhe projektvendimin për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Detyrimi ligjor për nxjerrjen e aktit.

Nga shkurti i vitit 2019, KLGJ-ja është angazhuar në një proces gjithëpërfshirës të vlerësimit të organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, në zbatim të neneve 13 dhe 15 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces evidentoi problematika në drejtim të: shpërndarjes së pabarabartë të ngarkesës midis gjyqtarëve, volumit të çështjeve të prapambetura, backlog-ut të krijuar, moshës së shqyrtimit të çështjeve me diferenca të konsiderueshme, prurjeve të çështjeve të reja dhe numrit efektiv të gjyqtarëve në detyrë, për të cilët palëvizshmëria ishte kthyer në përjashtim, e lëvizshmëria për të gjykuar nga një gjykatë në tjetrën, përbënte tashmë një rregull të diktuar nga nevojat. Gjetjet e mësipërme, të shoqëruara me një analizë të hollësishme të të dhënave statistikore, të kryer nga ekspertë ndërkombëtarë, konfirmuan se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbushte kërkesat ligjore, jo vetëm për gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, por edhe për gjykatat administrative të shkallës së parë.

Pas një procesi bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë (më tej MD) dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë e më gjerë, si dhe pas konsultimit me grupet e interesit, propozimi i përbashkët i KLGJ-së dhe MD-së “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” u miratua me vendimin nr. 495, datë 21.7.2022 të Këshillit të Ministrave, i botuar në fletoren zyrtare nr.107, datë 21.07.2022. Ky propozim parashikon, midis të tjerash, riorganizimin e gjykatave administrative të shkallës së parë në 2 (dy) gjykata.

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë të cilat fillojnë funksionimin në datën 1 korrik 2023, ushtrojnë funksionin e tyre në selitë dhe kompetencat tokësore të mëposhtme:

a) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë;

b) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, me seli në qytetin e Lushnjës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj VKM-je, me urdhrin nr.80, datë 27.07.2022 të Kryetares së KLGJ-së është ngritur dhe po funksionon një Grup Ndërinstitucional Pune, (në vijim GNP) i cili ka në përbërje përfaqësues të KLGJ (anëtarë dhe drejtues të lartë të administratës), gjyqtarë dhe kancelarë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të projekteve të mbështetjes teknike që e kanë shoqëruar KLGJ-në gjatë gjithë këtij procesi, si Projekti i zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMI-INL) dhe Këshilli i Evropës. Detyra e këtij GNP është ndërtimi i një plani të detajuar e funksional të zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, me shtylla kryesore të punës: burimet njerëzore, administrimi gjyqësor, administrata gjyqësore, godinat dhe infrastruktura, teknologjia e informacionit, administrimi i çështjeve, përgjegjësitë buxhetore e detyrimet financiare si dhe jo më pak i rëndësishëm, informimi i publikut.

Ky plan i detajuar pune i miratuar nga vetë grupi i punës, kërkon angazhimin e mbledhjes plenare për miratimin e akteve nënligjore, me karakter normativ apo kolektiv sipas rastit, si dhe kryerjen e një sërë veprimesh nga administrata e Këshillit në bashkëpunim me gjykatat, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të punës në 1 korrik 2023 në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë.

Projekt-aktet “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar” dhe “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë” i paraqiten për miratim mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore të këtij Këshilli, për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, veçanërisht në drejtim të ofrimit të

shërbimeve cilësore dhe në kohë nga gjykatat administrative të shkallës së parë, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të riorganizimit të kompetencave tokësore.

I. Natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor ekzistues

Aktet që i paraqiten për miratim Këshillit janë akte normative nënligjore, të cilat janë të harmonizuara me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor, si dhe Objektivin Strategjik 3 të Planit Strategjik të KLGJ-së 2022–2024, që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve efikase përmes miratimit dhe zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë e gjykatave.

Projektvendimet janë konceptuar si vendime kuadër që përcaktojnë tërësinë e parimeve që do të udhëheqin procesin e zbatimit të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë.

Fillimi i funksionimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e Lushnjë kërkon vendimmarrjen e Këshillit në shumë drejtime si: sistemimi në pozicione i gjyqtarëve të gjykatave që riorganizohen, i punonjësve që ofrojnë shërbime administrative e mbështetëse në këto gjykata, transferimi i çështjeve e dosjeve gjyqësore, funksionimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimit audio të seancave gjyqësore, infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe ajo fizike e godinave, komunikimi me publikun dhe përdoruesit e gjykatave etj.

II. Përputhshmëria e aktit me standardet ndërkombëtare

Projektvendimet janë hartuar duke marrë në konsideratë standardet më të mira ndërkombëtare të cilat kanë udhëhequr procesin e vlerësimit dhe përgatitjes së hartës së re gjyqësore, që synojnë të garantojnë specializimin dhe racionalizimin e shpenzimeve publike. Më konkretisht kanë qenë opinionet, rekomandimet dhe studimet e CEPEJ që ofrojnë ekuilibër midis parimeve ndërkombëtare të mirëpranuara si: a) aksesin në drejtësi; b) efikasitetin dhe eficientën e sistemit gjyqësor dhe c) cilësia e shërbimeve gjyqësore.

III. Komente të përgjithshme mbi aktin

Aktet e propozuara për miratim reflektojnë tërësinë e masave që duhen marrë paraprakisht me qëllim që konfigurimi i ri i propozuar të garantojë funksionalitetin e shërbimeve në gjykatë. Në të njëjtën kohë aktet i shërbejnë përmbushjes së nevojës për

rritjen e efijencës së shërbimeve gjyqësore dhe shpërndarjes në mënyrë proporcionale të ngarkesës së punës midis të gjithë gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë.

Konceptimi i akteve si vendime kuadër synon pasjen e vendimeve që orientojnë qartë dhe shërbejnë si udhërrëfyes për hapat e tjera të punës për riorganizimin e gjykatave sipas fazave të përcaktuara në VKM. Në të njëjtën kohë, pas miratimit këto vendime, i hapin rrugë miratimit të akteve të tjera të nevojshme që do të bëjnë të mundur vijimin e funksionalitetit të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë, sistemimin e administratës gjyqësore përmes ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit, apo miratimit të rregullave standarde dhe organikës së gjykatës, miratimit të rregullave të administrimit të çështjeve gjyqësore, etj. Veçanërisht për çështje që lidhen me teknologjinë e informacionit, vendimi kuadër përcakton shprehimisht përgjegjësinë e Drejtorisë së Administrimit Gjyqësor dhe të Teknologjisë së Informacionit për të ndjekur me prioritet procesin e harmonizimit të kërkesave ligjore e procedurale me elementet teknike të sistemeve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore me qëllim garantimin e funksionalitetit të plotë të tyre.

IV. Shpjegim i detajuar i përmbajtjes së aktit

Vendimet kuadër janë ndarë në 6 seksione dhe 8 nene në tërësi.

Seksioni I dhe neni 1 parashikojnë emërtimin dhe selinë e gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë, datën e fillimit të funksionimit në 1.07.2023, si dhe afatin kohor fundor kur gjykatat administrative Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë ndërpresin veprimtarinë e tyre, duke parashikuar datën 30.06.2023.

Seksioni II dhe neni 2 trajtojnë çështje që lidhen me organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë. Konkretisht në lidhje me gjyqtarët e këtyre gjykatave, vendimet nuk kanë përcaktuar numër konkret, duke parashikuar nevojën e nxjerrjes së një akti të veçantë të KLGJ-së, me qëllim që në eventualitetin e ndryshimit të këtij numri në të ardhmen, të mos jetë e nevojshme ndryshimi i përmbajtjes së vendimeve kuadër.

Parashikimet e këtij neni janë reflektim i parimeve kushtetuese të palëvizshmërisë dhe vijimësisë në ushtrimin e detyrës së gjyqtarëve të cilët janë të emëruar apo caktuar

në pozicione të përhershme në gjykatat administrative, sipas parashikimeve të neneve 42 pika 3 shkronja “b” dhe 44 pika 1 shkronja “a” të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për gjyqtarët e gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Lushnjë, për gjyqtarët e gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë, vendimet parashikojnë qëndrimin në pozicione të përhershme në strukturën e gjykatave administrative të shkallës së parë. Vijimësia në ushtrimin e funksionit për gjyqtarët e gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, të cilëve u suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit, sigurohet përmes transferimit të tyre në strukturën e gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë.

Seksioni 3 dhe neni 3, trajtojnë çështje që lidhen me organet e administrimit gjyqësor. Vendimet konfirmojnë edhe njëherë parime të parashikuara nga ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kështu në mungesë të kryetarit të Gjykatës të Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e Lushnjë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit, sipas ligjit apo nga zëvendëskryetari i zgjedhur rishtazi.

Vijimësia parashikohet për Kancelaren në detyrë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit (neni 83 i Ligjit 98/2016). Ndërsa kancelarët në detyrë të gjykatave të tjera administrative, duke qenë pjesë e administratës gjyqësore të gjykatave që mbarojnë funksionin, do t’i nënshtrohen procesit të ristrukturimit, për shkak të suprimimit të pozicionit, sipas parashikimeve të mëposhtme në projekt-akte.

Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas parashikimeve të Vendimit të KLGJ nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të Këshillit të Gjykatës”. Ndërsa Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë do të konstituohet më datë 01.07.2023.

Seksioni IV, neni 4 vendos rregulla për administrimin e brendshëm gjyqësor, duke synuar vijimin e ofrimit të shërbimeve gjyqësore, administrative dhe mbështetëse.

Neni 4 merr në konsideratë parashikimet ligjore të neni 66, pika 6 e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” duke evidentuar nevojën për miratimin e disa akteve të veçanta që detajojnë respektivisht rregullat për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe rregullat standarde për strukturën dhe organikën e administratës gjyqësore të gjykatave administrative.

Është parashikuar se administrata gjyqësore e Gjykatës Administrative Tiranë, e përbërë nga punonjësit e konfirmuar tashmë në detyrë nga Këshilli i Gjykatës, që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe ato mbështetëse sipas përcaktimeve në Ligjin 98/2016, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit. Ndërsa administrata gjyqësore e personave juridikë që mbarojnë për shkak të ndërprerjes së ushtrimit të funksionit në gjykatat e tjera administrative të shkallës së parë Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, pasi pozicionet e tyre suprimohen.

Procesi i ristrukturimit i hap rrugë sistemimit të të gjithë punonjësve të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, në pozicionet e strukturës së gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë, ose në gjykatat e tjera në rast se do të jetë e nevojshme. Grupi i punës është udhëhequr nga parimi i cituar që në momentin e përgatitjes së projektit për Hartën e re Gjyqësore, për sistemimin në pozicione në gjykata, të të gjithë personelit të gjykatave administrative të shkallës së parë që si persona juridikë i bashkohen gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë. Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit do të miratohet me një akt të veçantë të Këshillit, mbi bazën e parimeve të përcaktuara pikërisht në nenin 4 të projekt-akteve. Drafti përkatës është duke u përfunduar nga Grupi i punës.

Seksioni V, nenet 5 dhe 6 përcaktojnë parimet e transferimit dhe menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Konkretisht neni 5 parashikon se të gjitha çështjet gjyqësore të

regjistruara në gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë deri në datën 30.06.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen si çështje të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë (te riorganizuar) e Lushnjë. Çështjet gjyqësore që transferohen në gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS. Vendimet ngarkojnë shprehimisht Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit për të ndjekur procesin e transferimit dhe regjistrimit të tyre manualisht apo elektronikisht.

Në lidhje me menaxhimin e çështjeve gjyqësore të transferuara në gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë, vendimet parashikojnë se ato nuk rindahen me short elektronik. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

Seksioni VI neni 7, parashikon parimin e marrjes së përgjegjësive buxhetore dhe financiare nga gjykatat e administrative të shkallës së parë Tiranë e Lushnjë për shkak të mbarimit si persona juridikë të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Neni 8 parashikon rregullin e hyrjes në fuqi nisur nga natyra e aktit si akt normativ nënligjor.

V. Zbatimi i aktit

Zbatimi i akteve kuadër kërkon qasje proaktive nga të gjitha gjykatat, si organet drejtuese ashtu edhe administrata gjyqësore, për të bashkëpunuar ngushtësisht me KLGJ-në e për të siguruar vijimësi në ofrimin e shërbimeve, drejtësi efektive dhe në kohë për qytetarët.

VI. Efekte financiare të aktit

Aktet nuk krijojnë drejtpërdrejt efekte të tjera financiare për Hartën e re Gjyqësore, veç atyre të parashikuara më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur janë edhe dy vendimet kuadër që besoj i keni përpara.

Naureda Llagami: Atëherë, fillojmë me vendimin e parë që është “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar”.

Po!

Brikena Ukperaj: Atëherë, nisur nga vendimmarrja e djeshme e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku u shpallën tre pozicione të lira të përhershme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe nisur nga standardi apo praktika që kemi pasur me rastet e lëvizjeve paralele në gjykata të tjera që janë riorganizuar, siç ka qenë Durrësi dhe Tirana, propozoj që në nenin 2, pas pikës 3 të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “4. Pozicionet e shpallura për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të cilat më datë 01.07.2023 nuk ka përfunduar ende procedura e lëvizjes paralele, konsiderohen pozicione të lira të përhershme në strukturën e Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar. Këshilli i Lartë Gjyqësor pas datës 01.07.2023 vijon procedurat e papërfunduara për llogari të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar.”.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Po!

Dakord me propozimin nga ana e Komisionit.

Kështu e hedhim në votim me gjithë propozimin e bërë nga zonja Ukperaj që në nenin 1 të shtohet pika 4 me përmbajtjen që ajo lexoi. (*Bëhet fjalë për nenin 2.*)

Në tërësi jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit të Komisionit dhe propozimit të zonjës Ukperaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Ndonjë diskutim?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit që ka ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (relator z. Hallunaj).³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (relator z. Hallunaj).

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në çështjet e tjera të rendit të ditës.

Po vijojmë me çështjen e shqyrtimit të projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, me relator z. Dritan Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Parashtrij relacionin për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023.

Me Vendimin nr.11 – nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe me vendimet nr. 21 deri nr.24, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar kandidati {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë).

Është bërë shorti dhe janë filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, duke u caktuar unë si relator për këtë pikë.

Më tej është vijuar procedura duke u njoftuar kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit, caktimin e relatorit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin brenda tre ditëve, kërkesa për të cilat ka ardhur në dijeni dhe nuk ka shfaqur ndonjë pretendim me sa i është kërkuar.

Në vijim është bërë verifikimi i kriterëve të pasjes së përvojës profesionale minimale, të mospasjes masë disiplinore në fuqi. Sa i përket kriterit të përvojës profesionale minimale të kandidatit në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila në përgjigjen e shkresës nr.{...} prot., datë 07.04.2023 dhe komunikimin elektronik datë 07.04.2023, protokolluar me shkresën nr. prot. datë 1944/1, datë 07.04.2023, siç do të përshkruhet më poshtë.

Për përvojën profesionale specifike minimale, sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Administrative pranë Këshillit, rezulton që kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016. Me dekret nr. {...}, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës emërohet për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendim nr. {...}, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë Drejtësisë caktohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, datë 18.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, funksion të cilin e ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 7 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Është verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, nga vetëdeklarimi i magjistratit dhe nga informacioni i përcjellë i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”, nga gjithë dokumentacioni i paraqitur rezulton që për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë/Durrës.

Duke vlerësuar procedurën e verifikimit për z. {...} të plotë për pozicionin e lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të shpallur me vendimin nr. 17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023, relatori ia parashtroi atë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ky Komision në mbledhjen e datës 04.05.2023, vendosi kalimin për shqyrtim të çështjes në seancën plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e

Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr. 17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatorit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, të datës 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, (relator z. Dritan Hallunaj).⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|----------------------------|------------------|
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtim i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, të datës 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, të datës 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Po parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatës znj. {...}.

Me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale.

Me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshilli i Lartë Gjyqësor është vendosur: 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale.

Me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshilli i Lartë Gjyqësor është vendosur: 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale.

Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë është përcaktuar afati dyjavor i aplikimeve dhe në vijim të procedurave ka kandiduar edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Më tej është vijuar me fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit duke u caktuar edhe relatori, për të cilën jam caktuar unë.

Nga ana e relatorit kanë filluar procedurat që kanë të bëjnë kryesisht me njoftimin e kandidatit për fillimin e procedurave të verifikimit, për caktimin e relatorit dhe për të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari brenda 3 ditëve, për të cilat ka marrë dijeni dhe nuk ka shfaqur ndonjë pretendim të kësaj natyre.

Brenda afatit ligjor kandidatja ka depozituar dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së Protokollit të KLGJ-së si dhe formularin e deklaratës së pasurisë.

Gjithashtu, në respektim të vendimeve si më lartë të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten {...} u kërkuar dhe u

administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me komunikimin elektronik të datës 01.03.2023, dhe shkresën nr.{...} prot., datë 02.03.2023 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushat e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Të gjitha informacionet janë përcjellë me shkresat përkatëse me numër protokolli duke na informuar.

Vijojmë me rezultatet e verifikimit paraparak.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, për kandidaten znj. {...} konstatohet që ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 30.06.2004, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007 si dhe ka përfunduar “Master” në Shkenca Penale në Universitetin e Tiranës në vitin 2008. Me dekretin nr. {...}, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me dekretin nr. {...}, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 10.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, funksion të cilin ushtron edhe

aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 16 vite. Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat rezultojnë që për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, kandidatja znj. {...} rezultojnë të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kandidaten rezultojnë se për shkak të periudhës së hershme, nuk është e mundur gjetja e urdhrave të Kryetarit të Gjykatës për pjesëmarrjen në gjykime të çështjeve të ndryshme gjyqësore të znj. {...}. Gjithashtu rezultojnë, po nga kjo gjykatë, që gjyqtarja i janë shortuar për herë të parë më datë 18.01.2007 çështje civile, më datë 03.02.2007 çështje penale, më datë 30.03.2007 kërkesa penale themeli dhe më datë 16.04.2007 ka marrë për shqyrtim kërkesa për caktim mase sigurimi.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për kandidaten rezultojnë si vijon: urdhri nr. {...}, datë 08.01.2009 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione dhe trupa gjykues (rezultojnë pranë seksionit penal për të mitur); urdhri nr. {...}, datë 27.01.2011 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultojnë pranë seksionit civil; urdhri nr. {...}, datë 18.01.2012 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultojnë pranë seksionit civil; urdhri nr. {...}, datë 18.01.2008 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkëlidhur urdhër nr. {...}, datë 31.08.2007, rezultojnë pranë seksionit penal për të mitur.

Duke qenë se sipas urdhrave të mësipërm, kandidatja rezultojnë e caktuar disa raste pranë seksionit civil, nga ana e relatorit u kërkua informacion shtesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në funksion të verifikimit. Me anë të komunikimit elektronik të datës 06.04.2023, (shkresa nr. {...} prot., datë 06.04.2023 të Gjykatës Vlorë) sipas kësaj të fundit, gjatë periudhës nëntor 2007 deri korrik 2013, kandidatja ka gjykuar çështje penale si vijon: penale themeli – 403; penale ushtarake – 58; masa sigurimi – 351, përgjime – 23; penale të veçanta – 167.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit,

kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Në relacion është përcaktuar se çfarë kuptojmë me papajtueshmëri ambientale dhe rezulton nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, së për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, relatori ia parashtrroi atë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision në mbledhjen e datës 04.05.2023, vendosi kalimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj!

Atëherë, ftoj kolegët nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” (relator z. Klodian Kurushi).⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me hapjen e procedurave të komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesave për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Pa humbur kohë po filloj me relatimin e përgatitur nga Komisioni.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja “d” dhe nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016, si dhe në kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 ka vendosur: “Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur një kërkesë e vetme e një gjyqtareje që aktualisht ushtron funksionin si gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në vendimin nr. 40, datë 27.01.2023 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që ndiqet nga Këshilli në këtë rast.

Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të kandidimit. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 8 të Kreut II, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës.

Në përfundim të kësaj procedure, me vendimin nr.226, datë 08.05.2023 të Këshillit i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera është vendosur: 1. Përjashtimin e kandidatës, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosplotësimit të kriterit të vjetërsisë mbi 10 vjet. 2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.

Po për këtë pozicion, – pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës - nga ana e Shkollës së Magjistraturës në Këshill është depozituar kërkesa nr. 262/1 prot., datë 06.04.2023, nëpërmjet të cilës informohet se: “Me vendimin nr. 165, datë 05.04.2023 Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka shpallur një vend vakant në pozicionin pedagog i brendshëm. Në zbatim të këtij vendimi, Këshilli Drejtues ka vendosur që

kandidatura e përzgjedhur të jetë një kandidat nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas parashikimeve të nenit 265 pjesa IV e ligjit 115/2016.

Në vijim të kësaj shkrese kërkohet "... zgjatja e procedurave të komandimit sipas neneve 53 dhe 54 të ligjit nr.96/2016. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e pedagogut të brendshëm janë përcaktuar në nenin 264 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Vlerësimi i Komisionit

Për sa më lart, Komisioni vlerëson se kërkesa nr. 261/1prot., datë 06.04.2023 e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës për shpalljen e pozicionit pedagog i brendshëm përfshihet në sferën e pozicioneve të institucioneve të tjera brenda sistemit të drejtësisë, në kuptim të pikës 2 të nenit 53 të ligjit 96/2016 ku ndër të tjera është edhe pozicioni i komandimit në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit si dhe organizatat ndërkombëtare.

Këshilli investohet në këtë kërkesë të Shkollës, në kushtet kur procedura e shpallur me vendimin nr.40/2023 të Këshillit, po për të njëjtin pozicion përfundoi pa kandidatë të kualifikuar.

Ndaj sa më sipër, mbështetur në shkronjën "ë", pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën "a", pika 2, të nenit 61, në shkronjën "d" të nenit 86, në shkronjë "b", pika 1, të nenit 97, nenet 264 dhe 265 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin", i ndryshuar, mbi kërkesën e të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës sipas shkresës që unë e përmenda më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimin "Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Shkolla e Magjistraturës në njoftimin e publikuar në faqen e saj zyrtare elektronike, sipas vendimit nr. 16/2023 të Këshillit Drejtues, ka rishpallur 1 (një) vend vakant për pozicionin Pedagog i Brendshëm, ku përcakton se: "Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve magjistratë për pozicionin e pedagogut të brendshëm janë përcaktuar në

nenin 264 dhe 265, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për nisjen e procedurave të komandimit bazuar në nenet 53 dhe 54 të Ligjit “Për statusin”.

Në nenin 264 “Zgjedhja dhe emërimi i pedagogëve, përgjegjësve për programet e trajnimit dhe kancelarit” të ligjit nr.115/2016, parashikohet ndër të tjera se: “2. Pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse si pedagogë të brendshëm në sistemin universitar ose si pedagogë të jashtëm e të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, me eksperiencë mbi 10 vjet.”

Komisioni vlerëson të shpallet ky pozicion për komandim duke mbajtur në vëmendje situatën aktuale në gjykata:

Struktura Organizative: 408 gjyqtarë;

Organika në fakt: 303 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 220 gjyqtarë.

Si edhe mbajtur në konsideratë faktin se në vitin 2023 pritet të përfundojnë studimet në Shkollën e Magjistraturës 40 kandidatë për magistratë profili gjyqtar.

Struktura e projektvendimit:

Projektvendimi është i strukturuar në 2 (dy) krerë, të cilët trajtojnë në brendësi çështjet: i) shpalljes së kërkesave për kandidatura dhe ii) kohëzgjatjes, kriteret dhe procedurën e komandimit të gjyqtarit.

Kreu i I-rë bën fjalë për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Në pikën 1 të këtij kreu përcaktohet hapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës.

Në pikën 2 përcaktohet shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm.

Në pikën 3 përcaktohet se afati i paraqitjes së kërkesave për komandim të jetë dy javë nga shpallja e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose një datë fikse e përcaktuar të paktën 15 ditë nga mbledhja e Këshillit që do të shqyrtojë këtë projektvendim.

Në pikën 4 përcaktohet se bashkë me kërkesën për komandim, kandidati duhet të dorëzojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe dokumentet që provojnë plotësimin e kriterëve të komandimit.

Në Kreun II-të të projektvendimit, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit të gjyqtarit.

Sipas pikës 1 të këtij Kreu, kohëzgjatja e komandimit, në këtë pozicion të shpallur, përcaktohet të jetë 2 (dy) vjet me të drejtë ripërsëritje. Ky afat është brenda limitit maksimal të përcaktuar nga ligji, konkretisht pika 5, e nenit 53, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe pika 2 e nenit 265 të ligjit 115/2016. Njëkohësisht ky afat është edhe në përputhje më kërkesat specifike të institucionit. (mbajtur në vëmendje kërkesën e mëparshme të institucionit që kishte përcaktuar afatin 2-vjecar me të drejtë ripërtëritje).

Në pikën 2 të këtij Kreu, përcaktohen rastet e përfundimit të komandimit para afatit, në pozicionin e shpallur, konkretisht kur: a) kërkohet nga vetë gjyqtari për shkaqe të justifikuara (përderisa komandimi është me pëlqim); b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit, pra kur verifikohet kushti kryesor i komandimit; c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore; ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen; d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.

Në pikën 3 të këtij Kreu, jepen kushtet e komandimit, në pozicionin e shpallur, të përcaktuara nga neni 53 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht: a) komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së

mëparshme të komandimit dhe ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; d) kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Në vijim, në pikën 4 të Kreut II, jepen kriteret specifike të komandimit për pozicionin “Pedagog i Brendshëm”, pranë Shkollës së Magjistraturës, sikurse janë ato ligjore të përcaktuara nga neni 264 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe Aneksi 11 i Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë:

a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënie si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi dhjetë vjet; ose b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

Në pikën 5 të këtij Kreu, përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve dhe kriterëve të kandidimit, konkretisht parashikohet që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 6 të Kreut II, përcaktohet procedura që do ndiqet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi është apo jo në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.

Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre.

Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera ose kriteret e komandimit, me përjashtim të atij të mësimdhënies.

Lidhur me këtë përjashtim mbahet parasysh se, si rregull, referuar pikës 4, të nenit 52, të Ligjit nr.96/2016, Këshilli duhet të verifikojë kriteret e komandimit për çdo aplikant. Por, në rastin e mësimdhënies, ky është një kriter specifik, vlerësimi i saktë i të cilit mund të bëhet nga një institucion akademik, sikundër është dhe Shkolla e Magjistraturës. Përveç kësaj, praktikisht është e mundur që edhe të dhënat e mësimdhënies për aplikantët duhet të jepen dhe konfirmohen nga Shkolla e Magjistraturës, pranë të cilës gjyqtarët marrin pjesë si trajnerë.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 7 të këtij Kreu, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me Opinione të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre.

Në pikën 8 të këtij Kreu, parashikohet se vlerësimi i kriterit të komandimit të mësimdhënies për pozicionin vakant si më sipër, bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në zbatim të Rregullores së Brendshme të miratuar prej saj. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatin për depozitimin pranë saj të çdo dokumentacioni tjetër shtesë, me qëllim vlerësimin e plotësimit të kriterëve të tjera të parashikuara në Aneksin 11 të Rregullores së Shkollës.

Në pikën 9 të këtij Kreu, përcaktohet se, përzgjedhja e kandidatit për vendin vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm, bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Në pikën 10 të këtij Kreu, përcaktohet se, brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të kërkesës për komandim nga Shkolla, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarit të përzgjedhur, në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.

Së fundi, parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe u komunikohet gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi përkatës. Afatin në projektvendim për paraqitjen e kërkesave për komandim ne nuk e kemi vendosur në

varësi të mbledhjes. Meqenëse mbledhja mbahet sot, ne propozojmë një datë fikse që është dy javë, pra data 9 qershor 2023. Nuk është më pak se dy javë. Dy javë është data 8. Është 15-ditëshi dhe një ditë sa të botohet njoftimi, kështu që data 9 është 15-ditëshi.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Nëse nuk kemi diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votim duke vendosur edhe datën e propozuar nga relatori, data 9 qershor 2023.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarëve në Shkollën e Magjistraturës. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më datë 09.06.2023. Kërkesa, kohëzgjatja dhe procedura e komandimit miratohen sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...} për pozicionin e lirë e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (relator z. Dritan Hallunaj).⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|----------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...} për pozicionin e lirë e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të znj. {...} për pozicionin e lirë e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, relator i të cilit është z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Parashtroj relacionin “Për deklarin e përfunduar pa një

vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidates znj. {...}”.

Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e katërbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në lidhje me këto pozicione ka kandiduar edhe gjyqtarja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat (në kohën e kandidimit e transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë).

Duke vijuar më tej me fillimin e procedurave, caktimin e relatorit dhe njoftimin nga ana e relatorit për fillimin e procedurës, për caktimin e relatorit, si dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të ndonjë anëtari të Këshillit, për të cilat kandidatja ka marrë dijeni dhe nuk ka pasur ndonjë pretendim për pjesëmarrjen apo për relatorin e caktuar.

Në vijim kanë vijuar procedurat duke marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

Sa i përket kriterëve formale në fushën e së drejtës specifike si dhe kriterëve të tjera, është marrë informacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit, rezultoi që Këshilli me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 ka vendosur transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

Rrethana e faktit si më sipër, transferimi i gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pikërisht gjykata për të cilën ajo ka kandiduar për lëvizje paralele (në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile), ndikon në ecurinë e procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore dhe në përfundim në kualifikimin e kësaj kandidateje.

Me realizimin e transferimit të gjyqtares, konstatohet se ka rënë dhe shkak për të cilin kishte filluar procedura e verifikimit në kuadër të lëvizjes paralele. Për pasojë kjo procedurë verifikimi nuk mund të vazhdojë dhe duhet të përfundohet pa një vendim përfundimtar.

Referuar nenit 97, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikohet që “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

Referuar nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet që: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”. Ndërsa sipas nenit 95 të po këtij Kodi thuhet që: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Duke vlerësuar rrethanat e reja në të cilat ndodhet procesi i verifikimit për kandidaten znj. {...} në lidhje me kandidimin e saj për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, relatori i çështjes ia parashtrou atë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Ky Komision, në mbledhjen e datës 09.05.2023 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidates znj. {...} në kuadër të lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, pa vendim përfundimtar.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj!

Nëse nuk kemi diskutim kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidates znj. {...}, për shkak të transferimit të kandidates pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 të Këshillit.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarin { ... }”, (relatore znj. Yllka Rupa).⁷

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}”, (relatore znj. Yllka Rupa).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap znj. Yllka Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

Do të parashtoj relacionin e përgatitur nga Komisioni që ka për objekt miratimin e projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}”.

Në datë 18.01.2023 Këshilli ka hapur 10 (dhjetë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 10 (dhjetë) pozicione të lira të përhershme në

fushën e së drejtës civile. Po në këtë datë, Këshilli ka hapur 4 (katër) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet e mësipërme, Këshilli pasi ka verifikuar përvojën profesionale të secilit nga gjyqtarët kandidatë dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, në pikën e parë të tij, ka vendosur miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e mësipërme. Sipas këtij vendimi, vetëm për katër gjyqtarë konkretisht për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin e fundit kalendarik, përkatësisht vitin 2022, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional.

Në këto kushte, me vendimin nr. 144, datë 28.3.2023, Këshilli ka vendosur:

I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarët e lartpërmendur dhe gjyqtarin {...}. Gjithashtu është caktuar edhe relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësim për secilin prej tyre.

Pas marrjes së këtij vendimi, ka vijuar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit.

Ndërkohë që procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar nuk ka përfunduar, Këshilli me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023, pas shqyrtimit të kërkesës së kandidatit për tërheqjen nga kandidimi për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, ka vendosur përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, datë 18.01.2023, për kandidatin {...}.

Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele për shkak të tërheqjes së kandidatit, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2022 nuk mund të vazhdojë. Kjo procedurë vlerësimi, e filluar në rastin konkret për shkak të kandidimit për lëvizje paralele, zhvillohet bazuar në ligjin “Për statusin”, i cili në nenin

97 të tij parashikon se: “1. Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur...”. Në nenin 25 të ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, parashikohet se: “...3. Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magjistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre”.

Në kushtet kur procedura e lëvizjes paralele, për shkak të së cilës ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2022 për gjyqtarin {...} nuk ekziston, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar.

Në ligjin nr.96/2016 “Për statusin” nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli zbaton Kodin e Procedurës Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

Në rastin konkret, me deklarimin e përfundimit të procedurës për lëvizje paralele, shkak për të cilin ka filluar me prioritet procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, ka rënë shkak për të cilin kjo e fundit ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston më. Për pasojë vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional nuk mund të vazhdojë për këtë gjyqtar. Ndërkohë viti kalendarik 2022 për të cilin kishte filluar kjo procedurë vlerësimi për gjyqtarin z. {...}, do të përfshihet në

periudhën 5-vjeçare të vlerësimit në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të Ligjit për Statusin.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2022 për gjyqtarin {...}, për shkak të përfundimit të procedurës për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, datë 18.01.2023, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 189, datë 25.04.2023.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se viti kalendarik 2022 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të Ligjit “Për statusin”.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar t’i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Rupa!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Viti kalendarik 2022 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.

3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.05.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave: 06.03.2023, 13.03.2023 (2 mbledhje), 15.03.2023, 16.03.2023, 28.03.2023, 29.03.2023, 04.04.2023, 05.04.2023 (2 mbledhje).⁸

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta sipas rendit të ditës.

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj dhe Luan Dibra, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI - INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

8. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave: 06.03.2023, 13.03.2023 (2 mbledhje), 15.03.2023, 16.03.2023, 28.03.2023, 29.03.2023, 04.04.2023, 05.04.2023 (2 mbledhje).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, ju janë vënë në dispozicion procesverbalet e mbledhjeve që i përkojnë datave 6 mars, 13 mars, 15 mars, 16 mars, 28 mars, 29 mars, 4 prill dhe 5 prill.

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim për përmbajtjen, unë do ftoja kolegët që t'i miratojmë përmbajtjen e tyre.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 06.03.2023, 13.03.2023 (2 mbledhje), 15.03.2023, 16.03.2023, 28.03.2023, 29.03.2023, 04.04.2023, 05.04.2023 (2 mbledhje).

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, për të vijuar mbledhjen kemi edhe aktet e tjera të cilat për shkak të llojit të akteve do t'i zhvillojmë me dyer të mbyllura. Kështu që ftoj administratën të largohet për të lejuar shqyrtimin e këtyre akteve.

Shkëputet edhe lidhja me të tretët nëpërmjet platformës “online”.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

